



UNIVERSITETI I PRISHTINËS
"HASAN PRISHTINA"
FAKULTETI I INZHINIERISË MEKANIKE

Bregu i Diellit, 10 000 Prishtinë, Republika e Kosovës
Tel: +381 38 552 126 ext.101 • E-mail: fim@uni-pr.edu • www.uni-pr.edu

Nr. Prot.: 1526
Datë: 19/07/2016

E K S T R A K T

nga procesverbali i mbledhjes së Trupit Këshillëdhënës të Fakultetit të Inxhinierisë Mekanike – Prishtinë i mbajtur me dt. 13.07.2016 në orën 10:30-13:00

Mbledhjen e kryesoi dekani i Fakultetit të Inxhinierisë Mekanike (FIM), Prof. Asoc. Dr. Ahmet Shala. Përpos stafit menaxhues, profesorëve, asistente dhe laborantëve të FIM-it, në takim nga institucionet publike, private dhe bizneset morën pjesë:

1. Arben Gjukaj, Koorporata Energjetike e Kosovës sh.a., Prishtinë, Drejtor
2. Kemajl Zariqi, Fabrika e Veglave "PLUS" a.e. Sh.p.k. Ferizaj, Drejtor
3. Bedri Dragusha, Ministria e Zhvillimit Ekonomik, Prishtinë, Kryeshef Ekzekutiv i AKEE
4. Nebih Shatri, Ministria e Infrastrukturës, Prishtinë, Drejtor
5. Ibush Luzha, Drejtorja e Akreditimit të Kosovës – MTI, Prishtinë, Drejtor
6. Naim Baftiu, Instituti INKOS, Obiliq, Udhëheqës i Departamentit
7. Afrim Syla, N.T.SH. "ELEN", Prishtinë, Partner Menaxhues
8. Fatime Krasniqi, KSHAT "Tempulli", Prishtinë, Sekretare
9. Isa Dukaj, MTI, Prishtinë, Iniciativë Private
10. Xhemajl Gërguriu, N.T.P. "DACI", Fushë Kosovë, Menaxher
11. Fadil Berjani, N.T.SH. "DILLONI BENZ", Fushë Kosovë, Drejtor
12. Idriz Bytyçi, Qendra e Automjeteve të Kosovës "QAK", Fushë Kosovë, Inxhinier
13. Fitim Bajrami, "EUROMETAL" Sh.p.k., Ferizaj, Drejtor
14. Shefqet Kuçi, Sh.p.k "SOLID", Suharekë, Drejtor
15. Bekim Syla, "MERCOCOM COMPANY", Prishtinë, Menaxher
16. Avni Beqiri, Instituti INKOS, Obiliq, Udhëheqës i Departamentit
17. Ardian Dërvishaj, "METAL-ING" Sh.p.k., Deçan, Drejtor

Së pari Dekani i FIM-it, **Prof. Asoc. Dr. Ahmet Shala** i njoftoi të pranishmit lidhur me agjendën e dërguar për themelimit të Trupit Këshillëdhënës. Dekani dha një kronologji të shkurtër të zhvillimit të Fakultetit duke u nisur nga themelimi i tij e deri më sot, duke u nisur në programet aktuale, procesin e akreditimit, bashkëpunimin me ekonominë, skemën e organizimit të Fakultetit, stafin akademik, administrativ dhe studentët. Pas këtij njoftimi dekani i ftoj të pranishmit të japin një prezantim të shkurtër lidhur me emrin e organizatës që e përfaqësojnë dhe veprimtarinë se me çka merret institucioni i tyre.

Në takim përveç stafit nga FIM-it, përfaqësues nga institucionet qoftë publike dhe private dhe bizneseve ishin shtatëmbëdhjetë anëtarë.

Me pas fjalën e mori Prodekani për Cilësi dhe Bashkëpunim me Ekonomi **Prof. Ass. Dr. Shpetim Lajqi** i cili i njoftoi të pranishmit se në bazë të Statutit të UP-së, Senatit të UP-së dhe Këshillit të FIM-it është aprovuar Rregullorja për themelimin e Trupit Këshillëdhënës për secilën njësi akademike sipas veprimtarisë që ka. Gjithashtu i njoftoi të pranishmit se formimi i këtij trupi bazohet në vullnetin e mirë të anëtarëve të saj dhe është trup jo fitim prurës. Trupi Këshillëdhënës përbëhet nga përfaqësuesit e tregut të punës që janë vendimmarrës në kompani private apo publike. Anëtarë të këshillit *ex-officio* janë dekani dhe prodekanët e FIM-it. Po ashtu nga prodekani u prezantua në detaje përmbajtja e rregullores së trupit këshillëdhënës mbi bazën e se cilës do të funksionoj edhe ky trup në FIM.

Pastaj mbledhja vazhdoi me nënshkrimin e marrëveshjeve të bashkëpunimit me kompanitë pjesëmarrëse në takim dhe dekanit të FIM-it.

Në vazhdim fjalën e mori z. **Shefqet Kuçi** - Drejtor i ndërmarrjes "SOLID" i cili shprehi shqetësimet të cilat i ka fabrika e tij në lidhje me stafin dhe shprehi gatishmërinë që studentët ta kryejnë praktikën profesionale në ndërmarrjen e tij.

Sipas Rregullores në fjalë, anëtarët e Trupit Këshillëdhënës që janë nga tregu i punës duhet ta zgjedhin kryetarin dhe nënkryetarin. Propozimet dhe zgjedhjen duhet ta bëjnë anëtarët e zgjedhur të Trupit Këshillëdhënës të FIM-it.

Një propozim për Kryetar të Trupit Këshillëdhënës të FIM-it ishte për z. Arben Gjukaj, por ai nuk e pranoi, por tha që maksimalisht do ta përkrahi këtë Trupit Këshillëdhënës duke pas parasysh obligimet e mëdha që i ka me Korporatën Energjetike të Kosovës.

Propozimi tjetër ishte për z. **Kemajl Zariqi**, Drejtor në Fabrikën e Veglave "Plus" në Ferizaj. Pas votimit të hapur, z. **Kemajl Zariqi**, zgjidhet kryetar i Trupit Këshillëdhënës të FIM-it pa asnjë votë kundër.

Me pas vazhdoi propozimi për zgjedhjen e zëvendëskryetar ku u propozue z. **Afrim Syla**, Partner menaxhues në NTSH "Elen" i cili u votua nga të pranishmit dhe zgjidhet zëvendëskryetar i Trupit Këshillëdhënës të FIM-it pa asnjë votë kundër.

Në vazhdim z. **Kemajl Zariqi**, kryetar i Trupit Këshillëdhënës në FIM-it mbajti një fjalim të shkurtër falënderues për besimin e dhënë për këtë post kaq të rëndësishëm. Ai fton anëtarët për një bashkëpunim në vazhdimësi për nevojat dhe kërkesat e tregut të punës.

Dekani Prof. Asoc. Dr. Ahmet Shala në mënyrë zyrtare z. **Kemajl Zariqi** ia dorëzon Rregulloren e Trupit Këshillëdhënës të FIM-it të nxjerrur nga rregullorja e Senatit të UP-së.

Gjithashtu edhe zëvendëskryetari z. **Afrim Syla** i falënderoj anëtarët e Trupit Këshillëdhënës të FIM-it për votën dhe i ftoj të pranishmit që takimet të mbahen çdo tre muaj.

Dekani i falënderoj të pranishmit për pjesëmarrje dhe i ftoj të pranishmit për një vizitë në Laboratorët e Fakultetit të Inxhinierisë Mekanike.

Takimi përfundoi në orë 12:10.

Procesmbajtësja
Fatmire Kuçi-Sekretare e FIM

DEKANI
Prof. Asoc. Dr. Ahmet Shala

